

ITX ALBANIA SH.P.K.

**Raporti i Auditorit të Pavarur dhe
Pasqyrat Financiare më dhe
Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014**

PËRMBAJTJA

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

PASQYRAT FINANCIARE:

BILANCI KONTABËL	4
PASQYRA E TË ARDHURAVE DHE SHPENZIMEVE	5
PASQYRA E NDRYSHIMEVE NË KAPITAL	6
PASQYRA E RRJEDHËS SË PARASË	7
SHËNIME MBI PASQYRAT FINANCIARE	8-22

RAPORTI I AUDITORIT TË PAVARUR

Drejtuar aksionerëve dhe drejtimit të ITX Albania Sh.p.k.

Ne kemi audituar pasqyrat financiare të ITX Albanian Sh.p.k., të cilat përfshijnë bilancin kontabël më 31 dhjetor 2014, pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve, pasqyrën e ndryshimeve në kapitalin aksionar dhe pasqyrën e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, si dhe një përmbledhje të politikave bazë kontabël dhe shënimeve të tjera shpjeguese.

Përgjegjësia e Drejtimit për Pasqyrat Financiare

Drejtimi është përgjegjës për përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të këtyre pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit dhe për kontrollin e brendshëm i cili, në masën që përcaktohet nga Drejtimi, është i nevojshëm për të bërë të mundur përgatitjen e pasqyrave financiare pa pasaktësi materiale, si pasojë e mashtrimeve apo gabimeve.

Përgjegjësia e Auditorit

Përgjegjësia jonë është që, bazuar në auditimin tonë, të shprehim një opinion mbi këto pasqyra financiare. Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit. Këto standarde kërkojnë që ne të përmbushim kërkesat e etikës dhe të planifikojmë dhe të kryejmë auditimin, me qëllim që të përfitojmë siguri të arsyeshme që pasqyrat financiare nuk kanë pasaktësi materiale.

Auditimi përfshin kryerjen e procedurave për sigurimin e të dhënave të auditimit për vlerat dhe deklaratimet në pasqyrat financiare. Procedurat e përzgjedhura varen nga gjykimi i auditorit, përfshirë këtu dhe vlerësimin e rreziqeve të ekzistencës së pasaktësive materiale në pasqyrat financiare, qoftë si rezultat i mashtrimeve apo i gabimeve. Gjatë vlerësimit të rreziqeve, auditori merr në konsideratë kontrollin e brendshëm në lidhje me përgatitjen dhe paraqitjen e drejtë të pasqyrave financiare në mënyrë që të projektojë procedurat e auditimit, të cilat janë të përshtatshme në rrethana të caktuara, por jo për qëllimin e shprehjes së një opinionit mbi efektivitetin e kontrollit të brendshëm të Shoqërisë. Një auditim përfshin gjithashtu vlerësimin për përshtatshmërinë e politikave kontabël të përdorura dhe arsyeshmërinë e vlerësimeve kryesore të bëra nga Drejtimi, si dhe vlerësimin e paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Ne besojmë se të dhënat e auditimit që kemi marrë ofrojnë baza të mjaftueshme dhe të përshtatshme për dhënien e opinionit tonë të auditimit.

Opinionit

Sipas opinionit tonë, pasqyrat financiare paraqesin në mënyrë të drejtë, në të gjitha aspektet materiale, pozicionin financiar të ITX Albania Sh.p.k. më 31 dhjetor 2014 si dhe rezultatit e operacioneve të saj dhe rrjedhën e parasë për vitin e mbyllur në këtë datë, në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit.

Deloitte Audit Albania sh.p.k.
March 27, 2015
Tirana, Albania

Elvis Ziu
Partner Angazhimi




ITX Albania Sh.p.k.
Bilanci Kontabël më 31 dhjetor 2014
(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

	Shënime	Më 31 dhjetor 2014	Më 31 dhjetor 2013 (i paaudituar)
AKTIVE			
I. Aktive afatshkurtra			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	5	305,965	-
Llogari të arkëtueshme, neto		-	-
Inventari	6	130,216	-
Aktive të tjera	7	98,477	49
Totali i aktiveve afatshkurtra (I)		534,657	49
II. Aktive afatgjata			
Aktive afatgjata materiale	8	967,698	-
Aktive afatgjata të tjera	9	3,916	-
Totali i aktiveve afatgjata (II)		971,614	-
Totali i aktiveve (I+II)		1,506,271	49
Detyrime dhe kapitali aksionar			
I. Detyrime afatshkurtra			
Llogari të pagueshme	10	37,384	296
Huamarrje nga palët e lidhura	11	380,202	-
Të ardhura të shtyra	12	29,670	-
Detyrime të tjera	13	63,669	6
Totali i detyrimeve afatshkurtra (I)		510,925	302
II. Detyrime afatgjata			
Të ardhura të shtyra		393,128	-
Totali i detyrimeve afatgjata (II)		393,128	-
Totali i detyrimeve (I + II)		904,053	-
III. Kapitali aksionar			
Kapitali i regjistruar		400,000	-
Rezerva		-	-
Humbje të nimbartura		(253)	-
Fitimi / (humbja) për vitin		202,472	(253)
Totali i kapitalit aksionar (III)		602,218	(253)
Total i detyrimeve dhe kapitalit aksionar (I+II+III)		1,506,271	49

Bilanci kontabël duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese 5 deri në 21, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.


Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u miratuan dhe u nëshkruan më 26 mars 2015 nga:

Administratori





Manaxheri i Financës


4

ITX Albania Sh.p.k.

Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014


(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për periudhën nga data 27 nëntor deri më 31 dhjetor 2013 (e paaudituar)
I. Shitjet		
Të ardhura nga shitjet	1,178,095	-
Të ardhura të tjera	22,696	-
Totali i shitjeve (I)	1,200,790	-
II. Kosto e shitjeve		
Kostot e produkteve	(563,272)	-
Totali i kostos se shitjeve (II)	(563,272)	-
III. Shpenzimet		
Shpenzime të tjera nga veprimtaritë e shfrytëzimit	14 (202,278)	(246)
Shpenzime personeli	16 (97,528)	(7)
Amortizimi dhe zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale	8 (90,585)	-
Totali i shpenzimeve (III)	(367,894)	(253)
Humbja nga aktiviteti operativ (I+II+III)	246,683	-
IV. Të ardhura dhe shpenzime financiare		
Të ardhura financiare	15 7,696	-
Shpenzime financiare	15 (12,433)	-
Shpenzime financiare neto(IV)	(4,737)	-
Fitimi para tatimit (I-II-/+IV)	242,389	-
Tatimi mbi fitimin	17 39,917	-
Fitimi / (humbja) neto për vitin	202,472	(253)


Pasqyra e të ardhurave dhe shpenzimeve duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga 5 deri në 21, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u miratuan dhe u nëshkruan më 26 mars 2015 nga:

Administratori



Manaxheri i Financës

Jovida Spolun


ITX Albania Sh.p.k.

Pasqyra e ndryshimeve në kapital më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014


(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

	Kapitali aksionar	Humbje të akumuluar	Totali
Gjendja më 27 nëntor 2013	-	-	-
Kapital i paguar	-	-	-
Humbja për vitin	-	(253)	(253)
Gjendja më 31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>	-	(253)	(253)
Kapital i paguar	400,000	-	400,000
Firimi për vitin	-	202,472	202,472
Gjendja më 31 dhjetor 2014	400,000	202,218	602,218

Pasqyra e ndryshimeve në kapital duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga 5 deri në 21, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u miratuan dhe u nëshkruan më 26 mars 2015 nga:

Administratori



Manaxheri i Financës




ITX Albania Sh.p.k.

Pasqyra e rrjedhës së parasë për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014


(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

Shënime	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për periudhën nga data 27 nëntor deri më 31 dhjetor 2013 (i paaudituar)
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e shfrytëzimit		
Fitimi / (humbja) neto për vitin	202,472	(253)
<i>Rregullime për:</i>		
Zhverësimin	90,585	-
Shpenzimet e tatim fitimit e njohur në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	39,917	-
Shpenzimet financiare të njohura në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve	6,807	-
<i>Ndryshimet në kapitalin punues:</i>		
Rritje në llogaritë e arkëtueshme tregtare dhe të tjera	(98,428)	(49)
Rritje në inventar	(130,216)	-
Rritje në të ardhura të shtyra	422,798	-
Rënie në llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera	56,937	302
Interesa të paguara	(4,983)	-
Tatim fitimi i paguar	(20)	-
Rrjedha e parasë neto e gjeneruar nga (përdorur në) veprimtaritë e shfrytëzimit	585,870	(253)
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e investimit		
Blerje e aktiveve afatgjata materiale	(273,722)	-
Përmirësime të ambienteve me qira	(784,562)	-
Rrjedha e parasë neto e përdorur në veprimtaritë e investimit	(1,058,284)	-
Rrjedha e parasë nga veprimtaritë e financimit		
Arkëtime nga emëtimi i kapitalit aksionar	400,000	-
Arkëtime nga huatë	701,450	-
Pagesa të huasë	(323,072)	-
Rrjedha e parasë neto e gjeneruar nga veprimtaritë e financimit	778,378	-
Rritje neto në mjeteve monetare dhe ekuivalentët e tyre	305,965	-
Mjetet inonetare dhe ekuivalentet e tyre në 1 janar	-	-
VI. Mjetet monetare dhe ekuivalentet e tyre më 31 dhjetor	305,965	-


Pasqyra e rrjedhës së parasë duhet të lexohet së bashku me shënimet shpjeguese nga faqja 8 deri në 22, që janë pjesë përbërëse e pasqyrave financiare.

Pasqyrat financiare të Shoqërisë më dhe për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 u miratuan dhe u nëshkruan më 26 mars 2015 nga:

Administratori




Manaxheri i Financës



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

ITX Albania Sh.p.k. ("Shoqëria") u krijua si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me datë 27 nëntor 2013. Vendndodhja kryesore e aktivitetit është në Tiranë, Shqipëri. Shoqëria zotërohet 100% nga Zara Holding BV ("shoqëria mëmë").

Aktiviteti kryesor i Shoqërisë është shitja e produkteve të modës nëpërmjet dyqaneve me pakicë. Shoqëria aktualisht po manaxhon pesë dyqane të markave të ndryshme: Zara, Bershka, Stradivarius, Pull & Bear dhe Massimo Dutti, të cilat ndodhen në qendrën tregtare Tirana East Gate ("TEG") në Londër, Tiranë, Shqipëri që nga data 16 prill 2014.

Më 31 dhjetor 2014 Shoqëria kishte 165 punonjës (31 dhjetor 2013: 1 punonjës).

2. BAZA E PËRGATITJES SË PASQYRAVE FINANCIARE

2.1 Deklarata e pajtueshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (SKK), sipas Ligjit Nr. 9228, datë 29 prill 2004 "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare" (i ndryshuar).

(a) Monedha e funksionale dhe raportuese

Në përputhje me Ligjin nr. 9228, "Mbi Kontabilitetin dhe Pasqyrat Financiare", këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në Lekë, e cila është monedha funksionale e Shoqërisë.

(b) Ndryshimet në vlerësimet kontabël

Ndryshimet në vlerësimet kontabël njihen në periudhën në të cilën ato rishikohen, dhe jo në retrospektivë. Informacion të mëtejshme paraqiten në politikat kontabël 3(a) (iii) dhe 3 (b) dhe shënimet 8 dhe 9.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL

Politikat kryesore kontabël janë si më poshtë:

a. Aktive afatgjata materiale

(i) Njohja dhe matja

Zërat e aktiveve afatgjata materiale paraqiten me kosto minus zhvlerësimin e akumuluar dhe humbjet nga rënia në vlerë, nëse ka. Kosto përfshin shpenzime që lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivitetit. Kosto e aktiveve të ndërtuara nga vetë Shoqëria përfshin koston e materialeve dhe të fuqisë punëtore (nëse ka), si dhe ndonjë kosto tjetër që lidhet drejtpërdrejtë me vënien e aktivitetit në vendin dhe kushtet e nevojshme që ai të jetë i përdorshëm në mënyrën e synuar, si dhe kostot e çmontimit, largimit dhe restaurimit të vendit ku janë vendosur.

Të ardhurat dhe humbjet nga shitja e një aktivi afatgjatë material përcaktohen duke krahasuar të hyrat nga shitja e aktivitetit me vlerën kontabël të tij dhe njihen me vlerë neto tek "të ardhura të tjera" në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

(ii) Përmirësimet, riparimet dhe mirëmbajtja

Kostot që kanë të bëjnë me përmirësimet e mëpasshme dhe kostot e zëvendësimit të një elementi të aktiveve afatgjata materiale, i shtohen vlerës së tij kontabël neto vetëm nëse ato përbushin kriteret e përkufizimit të aktiveve afatgjata materiale dhe kriteret për njohjen e një aktivi (duke përfshirë dhe aftësinë e tyre për të marrë pjesë në gjenerimin e përfitimeve të ardhshme ekonomike). Kostot që lidhen me mirëmbajtjet dhe riparime të vazhdueshme njihen si shpenzime gjatë vitit ushtrimor.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**a. Aktive afatgjata materiale (vazhdim)***(iii) Amortizimi*

Amortizimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën lineare sipas jetëgjatësisë së çdo pjese apo njësie të aktiveve të trupëzuara nga dita e parë e muajit pasardhës pas muajit të blerjes.

Normat e amortizimit të përdorura nga Shoqëria janë si më poshtë:

Kategoria e aktiveve	Metoda e amortizimit	Përqindja e amortizimit
Orendi dhe instalime	Metoda lineare	35,23%
Pajisje elektronike	Metoda lineare	35,23%
Përmirësime të ambienteve të marra me qira (dyqanet)	Metoda lineare	11,11%
Përmirësime të ambienteve të marra me qira (zyra)	Metoda lineare	35,23%

Metodat e zhvlerësimit, jetëgjatësia dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale rishikohen, dhe rregullohen nëse është e përshtatshme, në çdo datë raportimi. Çdo ndryshim në periudhat ose metodat e zhvlerësimit do të konsiderohen si ndryshime në vlerësime kontabël.

b. Zhvlerësimi i aktiveve afatgjata materiale

Vlera kontabël neto e aktiveve afatgjata materiale zvogëlohet deri në shumën e rikuperueshme të aktivitetit, nëse kjo shumë është më e ulët se vlera e tij kontabël. Për të përcaktuar nëse një aktiv mund të këtë rënie në vlerë, kryhet një test, nëpërmjet të cilit vlerësohet shuma e rikuperueshme.

Një test zhvlerësimi kryhet në çdo datë të bilancit për aktivitet që tregojnë shenja të rënies në vlerë. Testi i zhvlerësimit kryhet me qëllim që të përcaktohet shuma e rikuperueshme e një aktiviteti afatgjatë, e cila është shuma më e lartë midis vlerës së drejtë të një aktiviteti afatgjatë (minus koston e shitjes) dhe vlerës në përdorim të tij. Vlera kontabël neto e aktivitetit reduktohet nëse si vlera e tij e drejtë (minus koston e shitjes) ashtu edhe vlera në përdorim janë më të ulëta se vlera e tij kontabël.

Nëse ka shenja që shuma e rikuperueshme e një aktiviteti afatgjatë është rritur mbi vlerën kontabël, humbja e mëparshme nga zhvlerësimi rimerret dhe vlera kontabël e aktivitetit rritet. Kufiri më i lartë i rritjes është vlera e mëparshme kontabël e aktivitetit afatgjatë minus amortizimin gjatë viteve të ndërmjetme, sikur të mos ishte njohur më parë rënie në vlerë.

Rimarrja e një rënie në vlerë njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve për periudhën raportuese, si një pakësim i humbjes nga zhvlerësimi.

c. Ç'rregjistrimi

Një aktiv afatgjatë material ç'rregjistrohet kur ai nxirret jashtë përdorimit apo kur nuk priten më përfitime të ardhshme ekonomike nga përdorimi apo nxjerrja jashtë përdorimit e tij. Çdo fitim ose humbje që vjen nga ç'rregjistrimi i aktivitetit (përcaktuar si diferencë mes arkëtimit të shitjes dhe vlerës së mbetur të aktivitetit) njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve kur aktiviteti ç'rregjistrohet.

d. Inventarët

Inventarët maten me vlerën më të ulët midis koston dhe vlerës neto të realizueshme. Kostot e drejtpërdrejta të materialeve përfshijnë, përveç çmimit të blerjes, edhe të gjitha kostot e tjera që nevojiten për ta sjellë inventarin në gjendjen dhe vendndodhjen ekzistuese. Vlera neto e realizueshme i referohet çmimit të shitjes që Shoqëria pret të përfitojë nga shitja e inventarit, në rrjedhën normale të biznesit, minus të gjitha kostot e vlerësuara për ndërlikimin e biznesit.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

e. Instrumentat financiarë

Instrumentat financiarë jo-derivativë përbëhen nga llogari dhe kërkesa të arkëtueshme, mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre dhe llogaritë e pagueshme tregtare dhe të tjera. Instrumentat financiarë jo-derivativë maten fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat që nuk mbahen me vlerën e drejtë përmes fitimit ose humbjes, çdo kosto të transaksioneve që janë direkt të atribueshme, përveç çfarë përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivet financiare ç'rregjistrohen nëse të drejtat kontraktuale të Shoqërisë në rrjedhën e parasë nga aktivet financiare skadojnë ose nëse Shoqëria ia transferon aktivet financiare një pale tjetër pa ruajtur kontrollin ose të gjitha rreziqet dhe përfitimet e aktivit.

Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare rregjistrohen në datën e tregtimit, p.sh. data në të cilën Shoqëria angazhohet të shesë apo të blejë aktivin. Detyrimet financiare ç'rregjistrohen nëse detyrimet e Shoqërisë të përcaktuara në kontratë skadojnë ose anulohen.

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre përbëhen nga vlera në arkë, llogaritë rrjedhëse bankare dhe depozitat bankare me maturitet tre muaj ose më pak nga data e lidhjes së kontratës. Ekuivalentet e parasë përfshijnë investime afatshkurtra, shumë likuide, të cilat janë lehtësisht të konvertueshme në para dhe kanë një rrezik minimal, përsa i përket ndryshimit të vlerës së drejtë.

Llogari dhe kërkesa të arkëtueshme

Llogaritë dhe kërkesat të arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas maten me kosto minus humbje nga zhvlerësimi, nëse ka. Zhvlerësimi i llogarive të arkëtueshme krijohet kur ka të dhëna objektive që Shoqëria nuk është e aftë të mbledhë të gjitha shumat për t'u arkëtuar sipas kushteve fillestare. Kostoja e amortizuar e llogarive dhe kërkesave të arkëtueshme afatshkurtra, në përgjithësi është e barabartë me vlerën e tyre nominale (minus provigjionet e krijuara për rënie në vlerë).

Detyrimet financiare

Detyrimet financiare njihen fillimisht me vlerën e drejtë të shumës për t'u paguar, duke përfshirë detyrimet për interesin e pageshëm në periudhat e ardhshme, me metodën e normës së interesit efektiv. Detyrimet financiare mbahen në vazhdim me koston e amortizuar.

Metoda e interesit efektiv

Metoda e interesit efektiv është një metodë për llogaritjen e koston së amortizuar të një detyrimi financiar dhe e shpërndarjes së shpenzimeve të interesit përgjatë periudhës. Norma efektive e interesit është norma që skanton rrjedhat e ardhshme të pagesave gjatë kohëzgjatjes së parashikuar të detyrimit financiar ose, kur është e përshtatshme, një periudhe më të shkurtër.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare

Shoqëria vlerëson në çdo datë të mbylljes së bilancit, nëse ka të dhëna që një aktiv financiar ose grup aktivesh financiare është zhvlerësuar. Nëse rezulton diçka e tillë, atëherë aktivi financiar i mbajtur me koston e amortizuar, zvogëlohet deri në vlerën aktuale të flukseve të përlogaritura të ardhshme të parasë (të skontuara me normën e interesit efektiv fillestar të aktivit financiar). Humbjet nga zhvlerësimi i aktivit financiar njihen si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Informacioni objektiv, që një aktiv ose grup aktivesh ka rënë në vlerë, përfshin të dhëna të vëzhgueshme për ngjarje si: vështirësi të mëdha financiare të huamarrësit, mosrespektim i kontratës (p.sh. rasti i dështimit ose i vonës në pagimin e interesave dhe të principalit); falimentimi dhe ristrukturime të tjera financiare të huamarrësit.

Zhvlerësimi i aktiveve financiare, individualisht të rëndësishme, vlerësohet veçmas për secilin aktiv. Aktivet financiare, të cilat nuk janë të rëndësishme individualisht dhe për të cilat nuk ka të dhëna për zhvlerësim, vlerësohen në mënyrë kolektive për ndonjë rënie në vlerë.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)**e. Instrumentat financiare (vazhdim)***Zhvlerësimi i aktiveve financiare (vazhdim)*

Humbja nga rënia në vlerë mund të anulohet nëse anulimi mund të lidhet objektivisht me një ngjarje që ka ndodhur pasi është njohur humbja nga zhvlerësimi. Rimarrja e humbjes nga zhvlerësimi njihet në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Ç'rregjistrimi

Një aktiv financiar ç'rregjistrohet kur Shoqëria humbet të drejtën mbi flukset e parave të aktivitetit financiar ose transferon të drejtën për të marrë flukset e parave që vijnë nga aktiviteti financiar në një transaksion në të cilën transferohen gjithashtu edhe të drejtat dhe rreziqet e pronësisë së aktivitetit financiar. Me ç'rregjistrimin e një aktiviteti financiar, diferenca mes vlerës kontabël të aktivitetit financiar dhe shumës së arkëtuar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Shoqëria ç'rregjistron një detyrim financiar kur detyrimet kontraktuale shkarkohen, anulohen ose skadojnë. Një detyrim financiar shkarkohet kur paguhet ose i transferohet me kontratë një pale tjetër. Një detyrim financiar anulohet vetëm nëse pala tjetër e anulon atë. Një detyrim financiar skadon në datat e paraqitura në legjislacionin përkatës. Diferenca mes vlerës kontabël të detyrimit financiar dhe shumës së paguar për të njihet në fitim ose humbje në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

f. Transaksionet në monedhë të huaj

Fitimi ose humbja nga konvertimi i zërave monetarë në monedhë të huaj është diferenca që rezulton nga një numër i dhënë njësisht të një monedhe të huaj në Lekë me kurse këmbimi të ndryshëm. Aktivitetet dhe detyrimet jo-monetarë të shprehura në monedhë të huaj përkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që maten me vlerën e drejtë ripërkthehen në Lekë me kursin e këmbimit të datës kur është përcaktuar vlera e drejtë.

Fitimet ose humbjet që vijnë nga ndryshimet e kursit të këmbimit raportohen neto në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve.

Kurset e këmbimit zyrtarë për monedhat kryesore të përdorura në përkthimin e zërave të bilancit kontabël të cilat shprehen në monedhë të huaj më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë (Leku ndaj kurseve të huaja të këmbimit):

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013
1 EUR	140.14	140.2
1 USD	115.23	101.86

g. Provigjionet

Provigjioni njihet nëse si rezultat i një ngjarjeje të kaluar, Shoqëria ka një detyrim aktual ligjor ose strukturor dhe nëse ekziston mundësia që të kërkohet një dalje burimesh e shprehur me përfitimet ekonomike për të shlyer detyrimin, e cila mund vlerësohet në mënyrë të besueshme.

Provigjionet përcaktohen duke skontuar rrjedhat e ardhshme të parasë me një normë para tatimit, e cila paraqet vlerësimet aktuale të tregut për vlerën në kohë të parasë dhe rreziqet specifike që lidhen me atë detyrim.

3. PËRMBLEDHJE E POLITIKAVE KRYESORE KONTABËL (VAZHDIM)

h. Të ardhurat dhe shpenzimet

Të ardhurat nga shitja vlerësohen me vlerën e drejtë të shumës së arkëtuar ose të arkëtueshme, duke marrë parasysh shumën e zbritjeve të ofruara dhe taksave të lidhura me shitjet.

Të ardhurat nga shitja e mallrave njihen kur Shoqëria i ka kaluar blerësit të gjitha rreziqet dhe përfitimet që lidhen me pronësinë e mallrave, kur është i mundur kthimi i shumës, kur shpenzimet e bëra në lidhje me transaksionin dhe kthimet e mundshme të mallrave mund të maten me besueshmëri, kur Shoqëria nuk vazhdon të jetë e përfshirë në mënyrë të vazhdueshme në menaxhimin e mallrave dhe shuma e të ardhurave mund të matet me besueshmëri. Transferimi zakonisht ndosh kur produkti i kalon klientit në pikën e shitjes.

Shoqëria njih si shpenzim çdo shtesë të rezervave për provigjione kundrejt rreziqeve, humbjeve, dëmtimit fizik ose kthimeve të mundshme që njihen në datën e pasqyrave financiare.

i. Të ardhura dhe shpenzime financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesat mbi fondet e investuara në depozita bankare dhe fitimet nga kursi i këmbimit. E ardhura nga interesi njihet kur ai përfitohet, duke përdorur metodën e interesit efektiv.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet e interesit për huatë e marra, humbjet nga kursi i këmbimit, ndryshimet në vlerën e drejtë të aktivitetit financiar nëpërmjet fitimit ose humbjes (nëse ka), dhe humbjeve nga zhvlerësimi i aktiveve financiare. Të gjitha kostot e huasë njihen në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve duke përdorur metodën e interesit efektiv.

j. Shpenzimi i tatimit mbi fitimin

Tatimi aktual është shuma e pritur e tatimit të pagueshëm mbi fitimin e tatueshëm të vitit, duke aplikuar normat tatimore në fuqi në datën e raportimit, si dhe çfarëdolloj rregullimi kontabël të tatimit për t'u paguar në lidhje me vitet e mëparshme. Shoqëria ka zgjedhur të aplikojë SKK 11 "Tatimi mbi fitimin" për njohjen e tatimit të shtyrë.

k. Pagesat e qirasë

Pagesat e qirasë së zakonshme njihen si shpenzime, duke përdorur metodën lineare përgjatë afatit të qirasë. Pagesat minimale të qirasë financiare ndahen në shpenzime financiare dhe pakësime të detyrimit të mbetur. Shpenzimet financiare shpërndahen gjatë afatit të qirasë me qëllim që të përfitohet një normë interesi periodike e qëndrueshme mbi gjendjen e mbetur të detyrimit.

4. PËRDORIMI I VLERËSIMEVE KONTABËL

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të kryejë gjykime, vlerësime dhe supozime, të cilat ndikojnë në aplikimin e politikave dhe shumave të raportuara të aktiveve dhe detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto supozime.

Vlerësimet dhe supozimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël njihen në periudhën në të cilën vlerësimi rishikohet dhe në periudhat e ardhshme, nëse ato ndikohen.

Në veçanti, informacioni për elemente të rëndësishëm në vlerësimin e pasigurive dhe gjykime kritike për aplikimin e politikave kontabël që kanë efekt material në vlerat kontabël në pasqyrat financiare përshkruhen në shënimet shpjeguese të mëposhtme.

Përdorimi i supozimeve kontabël është minimal në pasqyrat financiare aktuale duke marrë parasysh thjeshtësinë e natyrës së operacioneve që kryen Shoqëria.

Vlerësimet janë përdorur, por jo të kufizuara, në:

- Jeta e amortizueshme dhe vlera e mbetur e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale,
- Zbritje për inventarët dhe borxhet e dyshimta, dhe
- Çështjet ligjore.

Ngjarjet e ardhshme dhe ndikimi i tyre nuk mund të perceptohen me siguri. Prandaj, vlerësimet kontabël të bëra kërkojnë ushtrimin e gjykimit dhe gjykimi i përdorur në përgatitjen e pasqyrave financiare do të ndryshojë me krijimin e ngjarjeve të reja, me fitimin e përvojës, me marrjen e informacioneve shtesë dhe ndryshimin e mjedisit operues të Grupit. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga ato të vlerësuara.

Supozimet kryesore që lidhen me të ardhmen dhe burime të tjera kryesore të vlerësimin të pasigurisë në datën e bilancit, që kanë një rrezik të rëndësishëm në rregullimet materiale të vlerës kontabël neto të aktiveve dhe detyrimeve brenda vitit të ardhshëm financiar janë diskutuar më poshtë.

5. MJETE MONETARE DHE EKVIVALENTËT E TYRE

Mjetet monetare dhe ekuivalentët e tyre janë si më poshtë :

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Para në arkë	540	-
Lekë	540	-
Para në bankë	305,425	-
Lekë	292,946	-
Euro	12,479	-
TOTALI	305,965	-

6. INVENTARI

Gjendja e inventarit më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 është si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Mallrat të përfunduar	153,780	-
Provizjione për zhvleresime	(23,564)	-
TOTALI	130,216	-

Inventari njihet me koston e lëndëve të para dhe mallrave për rishitje dhe paraqitet me vlerën më të vogël midis koston dhe vlerës neto të realizueshme të mallrave të përfunduar. Në fund të periudhës Shoqëria përlllogarit një provigjion për mallrat te vjetëruara (p.sh. të cilat lidhen me katalogun e sezonit të mëparshëm).

7. AKTIVE TË TJERA

Aktivitet e tjera më 31 dhjetor 2014 and 2013 përbëhen si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
TVSH e arkëtueshme	63,585	-
Parapagim për qiratë	24,945	-
Të arkëtueshme nga palët e lidhura	6,904	-
Paradhënie për furnitoret	3,043	-
TOTALI	98,477	49

Shuma kryesore e aktiveve të tjera është e lidhur me shumën TVSH-së së arkëtueshme të gjeneruar nga aktiviteti investues i kryer nga Shoqëria për përmirësimet dhe punimet e kryera në dyqanet dhe zyrat e marra me qira.

Shuma e parapagimit të qirasë lidhet me shumat që Shoqëria i ka paguar çdo muaj qiradhënesit për hapësirat e marra me qira. Sipas kontratës, Shoqëria duhet t'i paguajë qiradhënesit një përqindje mbi shitjet vjetore për secilin dyqan. Në fund të vitit kryhet një rregullim në lidhje me shumën e parapaguar dhe shumën e detyruar. Më 31 dhjetor 2014 diferenca ka rezultuar në sasi më të larta të paguara, të cilat janë të regjistruar si parapagime.

ITX Albania Sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

8. AKTIVET AFATGJATA MATERIALE NETO

Kosto	Mobilje dhe pajisje	Pajisje elektronike	Përmirësime të ambjenteve me qira	Mobilje në proces	Totali
Më 27 nëntor 2013	-	-	-	-	-
Shtesa	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2013 (i paaudituar)	-	-	-	-	-
Shtesa	247,848	25,780	784,562	93	1,058,283
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	247,848	25,780	784,562	93	1,058,283
Amortizimi i akumuluar					
Amortizimi për vitin	-	-	-	-	-
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2013 (i paaudituar)	-	-	-	-	-
Amortizimi për vitin	19,874	4,064	66,647	-	90,585
Pakesime	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	19,874	4,064	66,647	-	90,585
Vlera kontabël neto					
Më 31 dhjetor 2013 (i paaudituar)	-	-	-	-	-
Më 31 dhjetor 2014	227,974	21,717	717,914	93	967,698

Përmirësimet e ambjenteve me qira lidhen me punimet e kryera nga Shoqëria në dyqanet e marra me qira, ku kryhet dhe aktiviteti i saj. Mobiljet dhe pajisjet lidhen me mobiljet e reja të blera për dyqanet dhe zyrën.

9. TATIMI I SHTYRË AKTIV

Shoqëria ka tatim të shtyrë aktiv në lidhje me diferencën që vjen nga aplikimi i normave të ndryshëm të amortizimit për qëllime fiskale dhe statutore. Shuma i është zbritur tatim fitimit për vitin. Për detaje të mëtejshme ju lutem shikoni shënimin 17.

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Amortizimi sipas SKK	90,585	-
Amortizimi sipas normave fiskale	64,473	-
Diferenca të përkohshme	26,112	-
Norma e takses	15%	10%
TOTALI	3,916	-

10. LLOGARI TË PAGUESHME

Llogaritë e pagueshme tregtare janë ndaj shoqërive të Grupit dhe lidhen me blerjen e mallrave të përfunduar, me të cilat Shoqëria kryen aktivitetin e saj.

11. HUA NGA PALËT E LIDHURA

Huatë nga palët e lidhura më 31 dhjetor 2014 dhe 2013 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Vlera aktuale	380,202	-
TOTALI	380,202	-

Shoqëria ka lidhur kontratë huaje me ITX Financien B.V., palë e lidhur, për shumën 5,000,000 Euro, e cila maturohet më 31 janar 2019 dhe ka një normë interesi Euribor 3 mujor plus rritje me 276 pikë. Detyrimi i huasë më 31 dhjetor 2014 përbëhet nga shuma e principalit të disbursuar prej 2,700,000 Euro dhe interesi përkatës i llogaritur.

12. TË ARDHURA TË SHTYRA

Shoqëria ka një të ardhur të shtyrë në lidhje me tarifat e hyrjes. Kjo shumë është regjistruar fillimisht si e ardhur e shtyrë dhe është amortizuar gjatë jetës së qirasë si zbritje e shpenzimit vjetor të qirasë.

Shuma mund të ndahet më tej në pjesën afatshkurtër dhe afatgjatë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Detyrimet e qirasë financiare afatshkurtër	29,670	-
Detyrimet e qirasë financiare afatgjatë	393,128	-
TOTALI	422,798	-

ITX Albania Sh.p.k.
Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014
(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

13. DETYRIME TË TJERA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2014 and 2013 janë si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Tatim fitimi i pagueshëm	43,814	-
Detyrime ndaj furnitorëve vendas	9,846	-
Detyrime ndaj punonjësve	5,986	-
Taksa të tjera të pagueshme	3,293	-
Kreditorë të tjerë	3,128	-
TOTALI	63,669	6

14. SHPENZIME TË TJERA OPERATIVE

Shpenzimet e tjera operative përbëhen si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për periudhën nga data 27 nëntor deri më 31 dhjetor 2013 <i>(I paaudituar)</i>
Qira	70,667	-
Shërbime ndaj Grupit	20,223	-
Energji elektrike	18,580	-
Dekorime për dyqanet	15,408	-
Çanta ,varëse dhe etiketa	15,336	-
Shërbime të tjera profesionale	11,568	-
Shpenzime rekrutimi	6,605	-
Komisione bankare	5,363	-
Shpenzime të tjera operative	53,937	-
TOTALI	202,278	246

Shpenzimet e tjera operative përbëhen kryesisht nga kosto që lidhen me shërbimet e pastrimit, shërbimet e sigurisë, uniformat, shpenzime udhëtimit dhe shpenzime të tjera operative më të vogla.

15. TË ARDHURA DHE SHPENZIME FINANCIARE

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për periudhën nga data 27 nëntor deri më 31 dhjetor 2013 <i>(I paaudituar)</i>
Të ardhura nga interesi	2,577	-
Fitim nga kursi i këmbimit	5,119	-
Të ardhura financiare	7,969	-
Shpenzime interesi	(6,807)	-
Humbje nga kursi i këmbimit	(5,626)	-
Shpenzime financiare	(12,433)	-
Shpenzime financiare neto	(4,737)	-

16. SHPENZIME PERSONELI

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për periudhën nga data 27 nëntor deri më 31 dhjetor 2013 (I paaudituar)
Paga bruto	85,160	7
Sigurimet shoqerore	12,368	-
TOTALI	97,528	7

Shoqëria ka 165 punonjës më 31 dhjetor 2014 (31 dhjetor 2013: 1 punonjës).

17. TATIMI MBI FITIMIN

Norma e aplikueshme e taksës për qëllim të llogaritjes së tatimit të shtyrë për vitin 2014 është 15% (2013:10%). Rakordimi midis fitimit kontabël para llogaritjes së taksës dhe bazës për llogaritjen e tatimit mbi fitimin për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014 është paraqitur si më poshtë:

	Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014	Për periudhën nga data 27 nëntor deri më 31 dhjetor 2013 (I paaudituar)
Fitimi para tatimit	242,389	(253)
Shpenzime të pazbritshme	49,837	-
Fitimi / (humbja) i tatueshëm	292,226	(253)
Norma e tatim fitimit	15%	10%
Shpenzimi për tatim fitimin	(43,834)	-
Tatim i shtyrë	3,917	-
Shpenzimi tatim fitimit neto	(39,917)	-

Shpenzimet e pazbritshme lidhen me shpenzime që nuk mund t'i zbriten llogaritjes së fitimit/humbjes së tatueshme dhe si rrjedhojë dhe e shpenzimit të tatim fitimit aktual.

18. PALËT E LIDHURA

Një transaksion me palët e lidhura është një transferim i burimeve, shërbimeve apo detyrimeve midis palëve të lidhura, pavarësisht nëse është caktuar një çmim. Një palë është e lidhur me një njësi ekonomike nëse kontrollon, kontrollohet nga, ose është nën një kontroll të përbashkët me njësinë ekonomike; ka një interes në njësinë ekonomike që i jep asaj influencë të konsiderueshme mbi njësinë; ose pala ushtron një kontroll të përbashkët mbi njësinë; pala është një pjesëmarrje e njësisë ekonomike; pala është një sipërmarrje e përbashkët në të cilën njësi ekonomike është një sipërmarrës; ose një nga anëtarët e personelit drejtues të njësisë apo të shoqërisë mëmë të saj (duke përfshirë familjarë të afërt të ndonjërit prej individëve të referuar më sipër).

18. PALËT E LIDHURA (VAZHDIM)

Më poshtë paraqiten palët e lidhura të Shoqërisë dhe gjendjet përkatëse më 31 dhjetor 2014 dhe 2013:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
<i>Të pagueshme / (arkëtueshme) nga palët e lidhura</i>		
ITX MERKEN B.V.	(6,904)	-
INDUSTRIA DE DISEÑO TEXTIL SA	11,792	-
GRUPO MASSIMO DUTTI SA	8,127	-
BERSHKA BSK ESPANA SA	5,174	-
TEMPE SA	3,735	-
PULL & BEAR ESPANA S.A.	3,474	-
STRADIVARIUS ESPANA SA	2,840	-
ZARA CROATIA, LTD	1,561	-
ITXR MACEDONIA DOOEL SKOPJE	613	-
	<u>37,316</u>	<u>-</u>
<i>Huamarrje nga palët e lidhura</i>		
ITX FINANCIEN B.V.	380,202	-
	<u>380,202</u>	<u>-</u>
TOTALI	<u>417,586</u>	<u>-</u>

ITX Albania Sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR

a) Rreziku i likuiditetit

Ekspozimi ndaj rrezikut të likuiditetit më 31 dhjetor 2014 është paraqitur si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2014	Vlera e mbartur	Deri në 3 muaj	3-6muaj	6-12muaj	Më shumë se 1 vit
<i>Aktive financiare</i>					
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	305,969	305,969	-	-	-
Aktive të tjera	98,477	52,671	-	-	-
Totali	404,446	358,640	45,806		
<i>Detyrime financiare</i>					
Llogari të pagueshme	(37,384)	(37,384)	-	-	-
Hua nga palët e lidhura	(380,202)	(268,508)	(111,694)	-	-
Detyrime për qiranë financiare	(422,798)	-	-	(29,670)	(393,128)
Totali	(840,384)	(305,892)	(111,694)	(29,670)	(393,128)
Pozicioni neto i likuiditetit	(435,938)	52,748	(65,888)	(29,670)	(393,128)

19. MANAXHIMI I RREZIKUT FINANCIAR (VAZHDIM)

b) Rreziku i kursit të këmbimit

Ekspozimi ndaj rrezikut të kurseve të këmbimit më 31 dhjetor 2014 paraqitet si më poshtë:

Më 31 dhjetor 2014	Vlera e mbartur	Euro	Lek
Aktive financiare			
Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre	305,965	12,479	293,485
Aktive të tjera	98,477	6,904	91,573
Totali	404,441	19,383	385,058
Detyrime financiare			
Llogari të pagueshme	(37,384)	(37,384)	-
Huamarrje nga palët e lidhura	(380,202)	(380,202)	-
Detyrime për qiranë financiare	(422,798)	-	(422,798)
Totali	(840,384)	(417,586)	(422,798)
Pozicioni neto	(435,943)	(398,203)	(37,740)

Analiza e ndryshimit ndaj ndryshimit të kurseve të këmbimit

Analiza e ndryshimit të paraqitur më poshtë është përcaktuar në bazë të ekspozimit në valutë të huaj në datën e raportimit dhe ndryshimeve të përcaktuara të ndodhura në fillim të vitit financiar dhe duke mbajtur konstant gjatë periudhës raportuese.

Më poshtë paraqiten ndikimet e ndryshimeve të kursit të këmbimit mbi fitimin neto, duke mbajtur të pandryshueshëm të gjithë variablat e tjerë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 (e paaudituar)
Euro zhvlerësohet me 10%	39,820	-
Euro rivlerësohet me 10%	(39,820)	-

Me një rritje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të Euros ndaj Lek-ut në datën e raportimit, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar të Shoqërisë do të shkaktonte një rritje prej 39,820 Lekë si rezultat i ekspozimit ndaj letrave me vlerë dhe gjendjeve të llogarive afatshkurtra të emëruara në Euro. Respektivisht, ndikimi në aktive do të ishte i njëjtë.

Me një ulje prej 10 përqind në kursin e këmbimit të Euro-s ndaj Lek-ut, ndikimi i përgjithshëm në rezultatin financiar dhe aktivet e Shoqërisë do të ishte e njëjtë, por në drejtim të kundërt me ndikimin e rritjes të përshkruar më sipër.

c) Rreziku i kredisë

Shoqëria nuk është e ekspozuar në mënyrë të konsiderueshme ndaj rrezikut të kredisë sepse shuma e llogarive të arkëtueshme është e barabartë me zero.

ITX Albania Sh.p.k.

Shënime mbi pasqyrat financiare për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2014

(Shumat janë shprehur në mijë Lekë)

20. ANGAZHIME

Angazhimet mbi kontratat e qirasë paraqiten si më poshtë:

	31 dhjetor 2014	31 dhjetor 2013 <i>(e paaudituar)</i>
Brenda një viti	161,044	-
Pas një viti por jo më shumë se 5 vjet	632,167	-
TOTALI	793,211	-

21. NGJARJE PAS DATËS SË BILANCIT

Nuk ka ngjarje të tjera pas datës së raportimit më dhe deri më 15 mars 2015 që kërkojnë rregullime apo informacione shpjegues shtesë në pasqyrat financiare të Shoqërisë.